



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 58 h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, 28 qershor), neni 17 i Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale) (Ligji Nr.06/L-092 botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 03.04.2019), neni 56 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 29.02.2024, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni I

EMËROHET komisioni për vlerësimin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale, me qëllim të zbatimit të procedurës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale në përbërje prej:

1. Isljam Redzepllar- nga ekzekutivi;
2. Ramadan Krasniqi - nga ekzekutivi;
3. Sevim Avdullahu - anëtar i Kuvendit të Komunës;
4. Gazmend Ramadani - anëtar i Kuvendit të Komunës;
5. Sinan Qafleshi - përf. i OJQ "Shahu",

Neni II

1.1.Komisioni emërohet me qëllim të zbatimit të procedurës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës:

1.2.Parcela Kadastrale P-70604038-00244-4 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Shajne , vendi i quajtur Dubrava-Mejdan Dubrava me sipërfaqe 12500 m²

Neni III

Detyrë e Komisionit është që të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore me të cilat parashihet dhënie në shfrytëzim dhe Këmbim e Pronës së Paluajtshme e Komunës, Rregullorës (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe dispozitat tjera ligjore të cilat janë në fuqi. Komisioni është i obliguar që në ankand ti parashih qartë kushtet dhe kriteret për të aplikuar në këtë ankand të cilat janë paraparë me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore.

Neni IV

Kryetar i këtij komisioni është eksperti – i emëruari i parë ose eksperti të cilin e zgjedhin vetë anëtarët e këtij komisioni.

Neni V

Administrata e Komunës është e obliguar që të ofrojë të gjithë mbështetjen e nevojshme me qëllim të efikasitetit të punës së Komisionit.

Neni VI

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

Neni VII

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në protokollin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës së Dragashit.

I dërgohet:

- MAPL-së (zyra ligjore) – Prishtinë;
- Komisionit për vlerësim, të gjithë anëtarëve;
- Drejtoratit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim;
- Arkivit;

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

01Nr. 060/01-4101/24-2

Dt. 29.02.2024



**Kryesuesje e Kuvendit
Arijeta Skeraj**

A. Skeraj